



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 12 shkurt 2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1229\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 paragrafi 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017 për shoqërinë "Hydro - Line" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC "Albaniku 4", me kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës;
- Vendimin V\_1124\_2019 të datës 28 mars 2019 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017 të lëshuar shoqërisë "Hydro - Line" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC "Albaniku 4", me kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës; dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017, edhe për dymbëdhjetë (12) muaj, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC "Albaniku 4", kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës, të datës 15.01.2020 të shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K., me adresë "Mbretëresha Teutë", p.n. -Mitrovicë, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 12 shkurt 2020 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K. dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC "Albaniku 4", kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës, edhe për dymbëdhjetë (12) muaj.



## Arsyetim

- ZRRE me datë 03.05.2013 nga ndërmarrja "Hydro-Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, HC "Albaniku 4", në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga shoqëria "Hydro Line" SH.P.K., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_539\_2013 me datë 28 qershor 2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 26.05.2015 nga shoqëria "Hydro-Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit V\_539\_2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, Hidrocentrali HC "Albaniku 4" Lokacioni ZK "Selac dhe Vidishiq", komuna e Mitrovicës, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante me datë 15.06.2015 ka aprovuar kërkesën me Vendimin V\_736\_2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_539\_2013 dt. 28 qershor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 28 dhjetor 2015, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni për marrjen e Autorizimit Final.
- ZRRE nga shoqëria "Hydro-Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizimin Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC "Albaniku 4", kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 27 shkurt 2017 pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit, ka vendosur që shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K., ti lëshohet Autorizimi Final V\_890\_2017 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC "Albaniku 4", kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës.
- ZRRE me datë 28.02.2019 nga shoqëria "Hydro Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017, për HC "Albaniku 4", kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës, për ndërtimin edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 27 shkurt 2020.



- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 mars 2019, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “Hydro Line” SH.P.K., dhe me Vendimin V\_1124\_2019 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_890\_2017 edhe për një (1) vit, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 15.01.2020 nga shoqëria “Hydro Line” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017, për HC Albaniku 4, kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës, për ndërtimin edhe për dymbëdhjetë (12) muaj.
- Shoqëria “Hydro Line” SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizim, dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: pas pranimit të vendimit për lëshimin e autorizimit nga Bordi i ZRRE-së, kanë filluar me përgatitjet teknike për të filluar me hapjen e rrugës dhe trases nëpër të cilën do të vendoset tubacioni duke filluar nga vepra e marrjes e deri te ndërtesa e Hidrocentralit HC Albaniku 4, janë bërë në mënyrë të vazhdueshme matjet e nevojshme gjeodezike nga ekspertët e fushës, është përgatitur bazamenti i vendosjes së veprës së marrjes dhe janë bërë të gjitha matjet e ndërtesës së hidrocentralit dhe vendosjes së turbinave sipas specifikave teknike të kërkuara nga ana e prodhuesit të turbinave.
- Shoqëria “Hydro Line” sh.p.k., në kërkesën e saj ka theksuar se edhe përkundër gatishmërisë për realizimin e këtij projekti me rëndësi të burimeve të renovueshme, është detyruar që të parashtrrojë kërkesë për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së autorizimit, pasi që arsyet për mos arritjen e finalizimit të këtij projekti brenda kësaj kohe janë shfaqur nga paraqitja e pengesave të cilat ishin jashtë kontrollit.
- Shoqëria “Hydro Line” sh.p.k., në kërkesën e saj ka theksuar se, se gjatë tre viteve të kaluara ka punuar në finalizimin e projektit Albaniku 2, projekt i cili është finalizuar në mes të vitit 2019, mirëpo për shkak të disa problemeve të paraqitura për shkak të sinkronizimit të rrjetit energjetik i ndërtuar nga ana e kompanisë dhe të kyçur në NS Trepça, është dashur të eliminohen këto pengesa, ku dhe janë filluar procedurat për fillim të fazës testuese. Arsyet tjera që kanë shtyrë mosrealizimin e këtij projekti janë se gjatë vitit 2019 janë paraqitur pengesa nga disa individ të cilët kanë kërkuar nga ana e komunës që të bëhet vlerësimi dhe verifikimi i ndërtimit të projekteve të kompanisë.
- Shoqëria “Hydro Line” sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se Komuna e Mitrovicës ka caktuar komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve eventuale nga hidrocentralet e Hydro Line shpk, dhe është kërkuar që të bëhet analizimi i situatës së përgjithshme, ndikimet, problemet kryesore, shqetësimet që ndërlidhen me sektorin e mjedisit në Mitrovicë në regjion të shalës, vendi ku janë ndërtuar hidrocentralet(njëra në operim tjera në fazën finale të përfundimit dhe 2 tjera të parapara për ndërtim.
- Komisioni vlerësues ka përgatitur raportin në harmoni me ligjet dhe rregulloret e Republikës të Kosovës, ku janë bërë vlerësimet e dëmeve eventuale, përfshirë një vlerësim të përgjithshëm të projekteve dhe kontekstin e tyre, që nga fazat e ndërtimit, duke trajtuar në mënyrë specifike komponentët e tij, masat e propozuara për të zbutur ndikimet negativ nëse nevojiten dhe monitorimin e zbatimit të këtyre masave zbutëse.



- *Pas pranimit të këtij raporti nga ana e komisionit të caktuar nga kryetari i komunës është vërtetuar se projektet e kompanisë Hydro Line shpk, janë ndërtuar në harmoni të plotë me lejet përkatëse të lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës, dhe është vërtetuar se dëme nuk janë shkaktuar as në ambient as në komunitet, dhe janë në harmoni edhe me standardet mjedisore dhe planifikimet e zhvillimit të turizmit në atë zonë.*
  - *Shoqëria Hydro Line SH.P.K., ka theksuar se, pas definimit dhe sqarimeve të pranuara kanë nisur që të bëjnë të gjitha përgatitjet që nga fillimi për realizimin e projektit Albaniku 4, pasi që deri në atë kohë ka pasur shumë paqartësi dhe hezitim nga ana e institucioneve financiare për mbështetjet e realizimit të këtij projekti, dhe tash kur janë definuar kanë arritur që ti finalizojnë edhe marrëveshjet me prodhuesin e turbinave, tubacionit dhe sigurimit e financimit shtesë.*
  - *Poashtu pas kërkesës nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Mitrovicës, kanë pranuar konfirmimin 08-355/02-0111673/19 të datës 15.01.2020 se leja ndërtimore është valide dhe punimet mund të realizohen në përputhje me kushtet e lejes ndërtimore dhe Ligjit të Ndërtimit.*
  - *Shoqëria Hydro Line SH.P.K., ka theksuar s,e arsyeja e kërkesës për shtyrje të vlefshmërisë së autorizimit për Hidrocentralin HC Albaniku 4., është përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e tyre në përfundimin e realizimit të] këtij projekti me interes të veçantë, nuk kanë arritur ta përfundojnë brenda afati të caktuar nga Bordi i ZRRE-së, për shkak të pengesave të paraqitura më lartë, dhe duke marr parasysh se këto projekte janë të sistemit kaskad, është dashtë të veprohet e kujdes të madh dhe të eliminohen të gjitha pengesat teknike, të cilat i kanë hasur gjatë realizimit të projektit HC Albaniku 3 dhe HC Albaniku 2, e të cilat janë finalizuar.*
  - *Andaj, duke pasur parasysh të gjitha ato që i paraqitëm më lartë, lusin Bordin e ZRRE-së, që bazuar në dispozitat ligjore të nenit 16 të Rregullës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në fuqi në datën e lëshimit të Autorizimit V\_890\_2017, të datës 27 shkurt 2017, për ndërtimin e hidrocentralit HC Albaniku 4. edhe për dymbëdhjetë (12) muaj, pasi që arsyet e mos realizimit të këtij projekti brenda afatit të parë të realizimit, kanë qenë jashtë kontrollit të kompanisë, për vetë faktin e arsyeve të paraqitura më lartë, dhe brenda këtij afati do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për të finalizuar projektin Albaniku 4, në pajtim me afatet ligjore të përcaktuara me Rregullën e Autorizimit.*
  - *Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës të shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Albaniku 4, me kapacitet të instaluar prej 1.119 MW, në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës, ka vlerësuar ato dhe ka konsideruar se për shkak të arsyeshmërisë së bazuar, dhe të kompleksitetit të ndërtimit të Hidrocentraleve, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_890\_2017 i datës 27 shkurt 2017, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.*
- II. **Vendimi për Lëshimin e Autorizim V\_890\_2016 i datës 27 shkurt 2017, do të vlen deri me datë 27 shkurt 2021, pas skadimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se pala nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.**
- III. **Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.**
- IV. **Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.**



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

Arsim Janova, U.D. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Bushati, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Mitrovicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së